

Konkurs për 5 anëtarë profesionalë, 1 anëtar përfaqësues të punonjësve dhe 1 anëtar përfaqësues të punëdhënësve në Bordin Drejtues të Fondit të Kursimeve Pensionale të Kosovës

Fondi i Kursimeve Pensionale i Kosovës (FKPK) është entitet i pavarur i cili vepron në Republikën e Kosovës në përputhje me të drejtat dhe përgjegjësitë që burojnë nga Ligji Nr. 04/L-101 i ndryshuar dhe plotësuar nga Ligji Nr. 04/L-168 për "Fondet pensionale në Kosovë" i Republikës së Kosovës (më tej "Ligji"); për administrim dhe menaxhim të kursimeve të obligueshme pensionale të punonjësve shtetas apo rezidentë të Kosovës.

FKPK është entitet jo-për-profit dhe qeveriset nga Bordi Drejtues prej shtatë (7) anëtarësh me të drejtë vote, ndërkohë që puna e përditshme e institucionit udhëhiqet nga Drejtori Menaxhues.

Anëtarët e Bordit Drejtues emërohen nga Kuvendi i Republikës së Kosovës me mandat katër (4) vjeçar me mundësi të rizgjedhjes.

Në përputhje me paragrafin 4.6 të Ligjit, Komisioni Përzgjedhës, i përbërë nga: Guvernatori i Bankës Qendrore i Republikës së Kosovës (Kryesues), Auditori i Përgjithshëm dhe Ministri i Financave i rekomandojnë Kuvendit kandidatët për anëtarë të Bordit Drejtues të FKPK-së.

Detyrat dhe përgjegjësitë e anëtarëve të Bordit Drejtues

Detyrat dhe përgjegjësitë e Bordit Drejtues, dhe anëtarëve të tij, përfshijnë (por nuk kufizohen vetëm në):

- Përgjegjësitë fiduciare për mjetet pensionale;
- Udhëheqjen e konkurseve për përzgjedhjen e menaxhues-it/ëve të mjeteve dhe mbajtësit të mjeteve ose instrumenteve për investime të hapura në pajtim me këtë Ligj;
- Zbatimin e marrëveshjeve me menaxhues-in/it e mjeteve, mbajtësit, instrumentet për investime të hapura, llogaritarët, revizorët, avokatët dhe kryerësit e tjerë të shërbimeve për FKPK-në;
- Kërkimin dhe pranimin e informacionit nga drejtorët e mjeteve, instrumentet për investime të hapura, mbajtësit e mjeteve dhe kryerësit e tjerë të shërbimeve për të gjitha transaksionet në emër të FKPK-së, duke përfshirë edhe votimin e aksioneve që i mban FKPK-ja;
- Miratimin e parimeve të investimeve për FKPK-në;
- Shkarkimin dhe zëvendësimin e drejtorit të mjeteve, instrumenteve për investime të hapura, mbajtësve të mjeteve dhe kryerësve të tjerë të shërbimeve të FKPK-së;
- Pagimin e fitimeve të llogarive individuale për pensionet e kursyera siguresve të anuiteteve me qëllim të blerjes së pensioneve për pjesëmarrësit dhe përfituesit në përputhje me këtë ligj;
- Lidhjen e marrëveshjeve për blerjen, shitjen, dhënien ose marrjen me qira të patundshmërive apo pajisjeve të nevojshme për funksionimin e FKPK-së;
- Punësimin e personelit ekzekutiv dhe joekzekutiv të FKPK-së;

- Lidhjen e marrëveshjeve të sigurimeve, duke përfshirë edhe sigurimin fiduciar për kompensim për këshillin drejtues, me kompanitë e sigurimeve të licencuara në Kosovë ose në shtetet anëtare të Organizatës për Bashkëpunim dhe Zhvillim Ekonomik;
- Përgatitjen e buxhetit, të cilin e miraton Bordi Drejtues;
- Propozimin për miratim në Kuvendin e Kosovës të taksave vjetore, që i ngarkohen mjeteve pensionale për shpenzimet e investimit dhe administrimit të FKPK-së.

Komisioni Përzgjedhës, në përputhje me paragrafin 4.8 të Ligjit, i fton të interesuarit të aplikojnë në përputhje me kërkesat e përgjithshme dhe specifike të listuara më poshtë.

I. Kërkesat e përgjithshme për të gjithë anëtarët e Bordit Drejtues të FKPK-së

- a.** Personat që dëshirojnë të bëhen anëtarë të Bordit Drejtues duhet të jenë me integritet të njohur dhe duhet ta kenë ekspertizë profesionale në çështjet pensionale, financiare, investuese dhe të sigurimit.
-Kandidati duhet të dorëzojë një CV dhe një letër motivuese, duke theksuar ekspertizën dhe përvojën e tij profesionale në çështjet e pensioneve, financave, investimeve dhe sigurimit.-
- b.** Personat të cilët janë bashkëshortë ose bashkëshorte, ose që kanë lidhje familjare deri në brezin e tretë, ose janë të afërm nëpërmjet lidhjes martesore deri në brezin e dytë me cilindo person në Komisionin Përzgjedhës, në Bordin Drejtues të FKPK-së, ose në Qeverinë e Republikës së Kosovës në pozitën e Ministrit ose më lartë, nuk do të propozohen si kandidatë.
-Kandidati duhet të dorëzojë një deklaratë të nënshkruar nën betim se ai ose ajo plotëson këtë kërkesë-
- c.** Personat të cilët janë dënuar për ndonjë krim, ose që janë të deklaruar të bankrotuar, ose të papërshtatshëm për të shërbyer si drejtor ose menaxher i ndonjë institucioni financiar në ndonjë vend, nuk do të emërohen si anëtarë të Bordit Drejtues të FKPK-së. Personat që janë udhëheqës ose të punësuar në ndonjërin prej menaxhuesve të mjeteve ose në ndonjërin prej kujdestarëve, ose janë pronarë të pesë (5) për qind ose më shumë të aksioneve në ndonjë menaxhues të mjeteve ose ndonjë kujdestar, nuk do të emërohen si anëtarë të Bordit Drejtues. Komisioni Përzgjedhës do të verifikojë dhe shqyrtojë përshtatshmërinë dhe prapavijën e kandidatëve të mundshëm.
-Kandidati duhet të dorëzojë një dëshmi zyrtare të lëshuar nga autoriteti përkatës shtetëror në vendin ku banon se nuk është dënuar për ndonjë krim. Një dëshmi e tillë nuk duhet të jetë më e vjetër se 6 muaj në datën e mbylljes së aplikimit dhe mund të jetë një certifikatë e lëshuar në mënyrë elektronike, p.sh. Certifikimi përmes portalit e-Kosova. Përveç kësaj, ai ose ajo duhet të dorëzojë një deklaratë të nënshkruar nën betim se ai ose ajo përmbush këtë kërkesë në tërësi. -
- Forma për deklaratën nën betim, siç specifikohet nën b. dhe c. më lart, është e bashkëngjitur në fund të këtij konkursi.-*

II. Kërkesat specifike për anëtarët profesionalë të Bordit Drejtues të FKPK-së

Në përputhje me paragrafin 4.4 të Ligjit, anëtari profesional duhet të ketë së paku dhjetë (10) vjet përvojë profesionale në lëmin e pensioneve si:

- a.** Punonjës, pronar, administrues i besuar ose këshilltar profesional i një kompanie për menaxhimin e mjeteve, ose një kompanie sigurimi ose të një fondi pensional me një vlerë të përgjithshme prej së paku pesëdhjetë milionë (50.000.000) euro nën menaxhim;
-Nëse kjo kërkesë është relevante për aplikimin e tij ose të saj, kandidati duhet të dorëzojë një letër reference ose një kontratë ose një letër konfirmimi.-

- b.** Ekonomist ose analist financiar në një institucion financiar të madh ndërkombëtar;
-Nëse kjo kërkesë është relevante për aplikimin e tij/saj, kandidati duhet të dorëzojë një letër reference ose një kontratë ose një letër konfirmimi.-
- c.** Ekspert në fushën e shkencave ekonomike ose të financave, që ka bërë hulumtime të gjera akademike të pranuar ndërkombëtarisht ose ka punime shkencore për investimet private pensionale;
-Nëse kjo kërkesë është relevante për aplikimin e tij/saj, kandidati duhet të dorëzojë punimet e tij/saj të publikuara.-
- d.** Personat e emëruar për anëtarë të Bordit Drejtues mund të jenë ekspertë ndërkombëtarë në fushën e studimeve të tyre.
-Nëse kjo kërkesë është relevante për aplikimin e tij/saj, kandidati duhet të dorëzojë një letër reference ose një kontratë ose një letër konfirmimi.-

Ju lutemi vini re se dokumentacioni i dorëzuar siç kërkohet sipas Kërkesave specifike për anëtarët profesionalë, së bashku me CV-në dhe letrën motivuese, duhet të dëshmojë qartë dhe pa mëdyshje kohëzgjatjen, d.m.th. datën e fillimit dhe datën e përfundimit të çdo pozicioni relevant të mbajtur, dhe përmbajtjen e ekspertizës dhe përvojës profesionale të kërkuar në çështjet e pensioneve, financave, investimeve dhe sigurimit.

III. Kërkesat specifike për anëtarin përfaqësues të punonjësve në Bordin Drejtues të FKPK-së

- a.** Duhet të ketë përvojë profesionale në përfaqësimin ose këshillimin e punonjësve apo përfaqësuesve të tyre në Kosovë;
-Kandidati duhet të dorëzojë të paktën një letër reference. Letrat e referencës duhet t'i referohen pozicioneve përkatëse të punësimit ose roleve zyrtare të kandidatit.-

IV. Kërkesat specifike për anëtarin përfaqësues të punëdhënësve në Bordin Drejtues të FKPK-së

- a.** Të ketë përvojë profesionale në përfaqësimin ose këshillimin e punëdhënësve në Kosovë;
-Kandidati duhet të dorëzojë të paktën një letër reference. Letrat e referencës duhet t'i referohen pozicioneve përkatëse të punësimit ose roleve zyrtare të kandidatit.-

Afati dhe mënyra e aplikimit

Afati i fundit për aplikim është më **5 maj 2023, ora 16:00**. Aplikimi duhet të bëhet përmes postës elektronike në **trusti@bqk-kos.org**, duke i bashkangjitur dokumentet e renditura në mënyrë të përmbledhur më poshtë dhe duke specifikuar pozitën e anëtarit të Bordit Drejtues të FKPK-së për të cilën po aplikoni (anëtar profesional ose anëtar përfaqësues i punonjësve ose anëtar përfaqësues i punëdhënësve)

Aplikacioni për anëtar profesional të Bordit Drejtues (5 pozita) duhet të përfshijë dokumentet në vijim: 1. Kopje letërnjoftimi, 2. CV (siç është detajuar më sipër nën I.a.), 3. Letër motivuese [siç është detajuar më sipër nën I.a.], 4. Deklaratë nën betim [siç është detajuar më sipër nën I.b. dhe I.c.], 5. Dëshmi zyrtarë të mosdënimit për ndonjë një krim [siç është detajuar më sipër nën I.c.], dhe, siç mund të jetë e

aplikueshme, **6. letra(at) e referencës, kontrata(at) dhe/ose letra(at) e konfirmimit** [siç është detajuar më sipër nën II.a., II.b. dhe II.d.] **dhe/ose punime të publikuara** [siç është detajuar më sipër nën II.c.]

Aplikacioni për anëtar përfaqësues të punonjësve në Bordit Drejtues (1 pozitë) duhet të përfshijë dokumentet në vijim:

1. Kopje letërnjoftimi, 2. CV (siç është detajuar më sipër nën I.a.), **3. Letër motivuese** [siç është detajuar më sipër nën I.a.], **4. Deklaratë nën betim** [siç është detajuar më sipër nën I.b. dhe I.c.], **5. Dëshmi zyrtarë të mosdënimit për ndonjë krim** [siç është detajuar më sipër nën I.c.], dhe **6. letra(at) e referencës** [siç është detajuar më sipër nën III.a.]

Aplikacioni për anëtar përfaqësues të punëdhënësve në Bordit Drejtues (1 pozitë) duhet të përfshijë dokumentet në vijim:

1. Kopje letërnjoftimi, 2. CV (siç është detajuar më sipër nën I.a.), **3. Letër motivuese** [siç është detajuar më sipër nën I.a.], **4. Deklaratë nën betim** [siç është detajuar më sipër nën I.b. dhe I.c.], **5. Dëshmi zyrtarë të mosdënimit për ndonjë krim** [siç është detajuar më sipër nën I.c.], dhe **6. letra(at) e referencës** [siç është detajuar më sipër nën IV.a.]

Komunitetet joshumicë dhe pjesëtarët e tyre, gjinia e nënpërfaqësuar dhe personat me aftësi të kufizuara inkurajohen të aplikojnë për pozitat e shpallura.

Ky proces rekrutimi do të monitorohet nga përfaqësues të Projektit Britanik të Emërimeve të Menaxhmentit të Lartë. Kandidatët njoftohen se emrat, rezultatet dhe kualifikimet e kandidatëve të ranguar më së larti në këtë konkurs si ‘të nominuar’, do të publikohen në faqen e projektit dhe se me aplikimin për këtë pozitë do të konsiderohet se është dhënë pëlqimi për publikim.

Për vërtetimin e përshtatshmërisë së kandidatëve, Komisioni Përzgjedhës synon të bëjë verifikimet e nevojshme me autoritetet përkatëse shtetërore.

DEKLARATË NËN BETIM

Unë, i nënshkruari më poshtë, me qëllim të aplikimit për pozitën e anëtarit të Bordit Drejtues të Fondit të Kursimeve Pensionale të Kosovës (FKPK), në përputhje me kërkesat e sanksionuara me Ligjin Nr. 04/L-101 për Fondet Pensionale të Kosovës, me ndryshime dhe plotësime, dhe të parashtruara në konkurs, deklaroj se

- NUK jam zyrtar ose punonjës i ndonjë menaxhuesi të mjeteve ose ndonjë kujdestari ose pronar i pesë (5) për qind ose më shumë të aksioneve në ndonjë menaxhues të mjeteve ose ndonjë kujdestar;

- NUK kam qenë i dënuar për ndonjë krim ose i deklaruar i bankrotuar ose i paaftë për të shërbyer si drejtor ose menaxher i ndonjë institucioni financiar në ndonjë vend; dhe

- NUK jam bashkëshort ose bashkëshorte, ose në lidhje familjare deri në brezin e tretë, ose i afërm nëpërmjet lidhjes martesore deri në brezin e dytë me cilindo person në Komisionin Përzgjedhës, në Bordin Drejtues të FKPK-së, ose në Qeverinë e Republikës së Kosovës në pozitën e Ministrit ose më lart.

Emri dhe mbiemri

Numri i letërnjoftimit

Data dhe vendi

Nënshkrimi